



## **VENDIM MBI PRANUESHMËRI**

**Data e miratimit: 29 shtator 2015**

**Numri i lëndës: 2014-34**

**Rejhane Sadiku-Syla**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 29 dhe 30 shtator 2015, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese  
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar  
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore  
Z. Paul LANDERS, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **PROCEDURAT PRANË PANELIT**

1. Ankesa është regjistruar më 4 korrik 2014.

2. Më 27 gusht 2014, Paneli vendosi të njoftonte shefin e Misionit (ShM) të EULEX-it rreth ankesës, duke e ftuar atë të paraqes vërejtjet e tij me shkrim për ankesën. Gjithashtu u vendos të shqyrtohen meritat e aplikacionit në të njëjtën kohë me pranueshmërinë e tij (në pajtim me rregullin 30 par. 1 dhe 2 të Rregullores së Punës së Panelit, më tutje si RrP).
3. Vërejtjet e ShM janë pranuar më 12 nëntor 2014, ku më pastaj u janë komunikuar ankueses për vërejtje shtesë nga ajo.
4. Më 1 dhjetor 2014, ankuesi ka dërguar vërejtje shtesë, të cilat me rend i janë dërguar ShM për informim.

## **FAKTET**

### **I. RRETHANAT E LËNDËS**

5. Më 7 dhjetor 2000, në orës 10:30, z. Sylë Sadiku, babai i ankueses, ishte zhdukur nga shtëpia e tij në pjesën veriore të Mitrovicës, kur dyshohet se ishte sulmuar nga një grup personash të armatosur, që thuhet se kanë qenë të përkatësisë etnike serbe. Sulmi ishte parë nga motra e ankueses, e cila arriti të largohej dhe e cila ishte evakuuar më vonë nga trupat franceze të KFOR-it. Që nga ajo datë, ankuesja nuk ka pasur asnjë informacion rreth vendndodhjes dhe fatit të babait të saj.
6. Midis 8 dhjetorit 2000 dhe 17 shkurtit 2001, trupat franceze të KFOR-it dhe policia e UNMIK-ut morën disa deklaratë nga tre anëtarë të paspecifikuar të familjes së personit të zhdukur. Po ashtu ishte urdhëruar edhe një kontroll i zonës nga ajri. Këto hapa hetimorë ishin të pasuksesshme dhe z. Sadiku apo mbetjet e tij nuk janë gjetur. Rasti mbeti i hapur, por joaktiv.
7. Në dhjetor të vitit 2008, baza e të dhënave të UNMIK-ut, dosjet dhe arkivat e tyre janë bartur në Departamentin e EULEX-it të Mjekësisë Ligjore (DML). Dosja e lëndës lidhur me zhdukjen e babait të ankueses përfshin raportin e pranisë së KFOR-it francez nga vendi i incidentit dhe raportin e incidentit të policisë së UNMIK-ut, duke përfshi tri deklaratë të dëshmitarëve.
8. Megjithatë, duket se dosja e lëndës nuk ishte dorëzuar nga UNMIK-u në prokurorinë e EULEX-it. Nuk ka asnjë informacion në bazën e të dhënave të prokurorisë së EULEX-it sa i përket kësaj lënde.
9. Më 6 dhjetor 2013, ankuesja i ka dorëzuar një letër shefit të Misionit të EULEX-it (ShM) duke kërkuar informacion mbi rrethanat e zhdukjes së babait të saj dhe duke pyetur EULEX-in rreth ndonjë hapi hetimor apo prokurorial të ndërmarrë në këtë lëndë.

10. Më 20 dhjetor 2013, ankuesja ka marrë një përgjigje nga Zyra e Shefit të Stafit të EULEX-it. Aty deklarohet se Departamenti i Mjekësisë Ligjore (DML) i EULEX-it ka konfirmuar se eshtrat e babait të ankueses ishin të pagjetura. Prandaj në DML lënda ka mbetur aktive dhe e hapur. Megjithatë letra nuk ka adresuar pyetjet e ankueses në lidhje me hapat hetimor apo prokurorial të ndërmarra në këtë lëndë.
11. Më 5 shkurt 2014, ankuesja ka dërguar një letër të dytë ShM-së, duke kërkuar sqarime mbi obligimin e prokurorëve të EULEX-it për të kryer një hetim penal efektiv rreth lëndës dhe duke paraqitur pyetje të tjera në lidhje me aspekte të ndryshme procedurale të hetimit.
12. Më 14 shkurt 2014, Zyra e Shefit të Stafit ka dërguar një përgjigje, në të cilën ai tha se mund që vetëm ta përsërit informatën e dhënë në letrën e tij të 20 dhjetorit 2013.
13. Më 26 mars 2014, ankuesja i ka dorëzuar një letër prokurorisë së EULEX-it të prokurorisë speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) duke kërkuar zyrtarisht një hetim rreth rrethanave të zhdukjes së babait të saj.
14. Më 3 prill 2014, ankuesja ka marrë një përgjigje nga shefi i PSRK-së ku deklarohet se baza e të dhënave të tyre nuk ka përmbajtur asnjë informacion në lidhje me lëndën. Ai rekomandoi që ankuesja duhet të kontaktoj ekipin mobil të EULEX-it apo zyrën e prokurorisë themelore në Mitrovicë për të verifikuar nëse ata kishin informata rreth lëndës.
15. Më 22 prill 2014, ankuesja ka paraqitur një kërkesë tek ekipi mobil i prokurorëve të EULEX-it me kërkesën që të hetohet zhdukja e babait të saj.
16. Me 13 qershor 2014, ekipi mobil i prokurorëve të EULEX-it e informoi ankuesen se *"Baza e të dhënave e Prokurorisë së EULEX-it në Mitrovicë nuk posedon ndonjë informatë rreth rastit e as informata rreth veprimeve që mund të jenë kryer në këtë lëndë"*. Ekipi mobil po ashtu ka treguar se çështja nuk ka hyrë në kuadër të kompetencave të zyrës së prokurorisë së EULEX-it, pasi kjo kishte të bënte me një çështje penale, e cila duhej të raportohet në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, ku dhe e kishin referuar lëndën.

## II. LIGJI PËRKATËS NË FUQI

**VEPRIMI I PËRBASHKËT I KËSHILLIT 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008 rreth Misionit Evropian mbi Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX-i në KOSOVË**

### Neni 2 Deklarata e Misionit

EULEX-i NË KOSOVË do të ndihmoj institucionet e Kosovës, autoritetet gjyqësore dhe agjencitë për zbatimin e ligjit në përparimin e tyre drejt

qëndrueshmërisë dhe llogaridhënies, dhe në zhvillimin dhe forcimin e një sistemi të pavarur shumë-etnik të drejtësisë, policisë dhe shërbimit doganor, duke siguruar se këto institucione nuk iu nënshtrohen ndërhyrjeve politike dhe përfillin standardet e njohura ndërkombëtare dhe praktikat më të mira evropiane.

### **Neni 3 Detyrat**

Në mënyrë që të përmbushet Deklarata e Misionit e përcaktuar në Nenin 2, EULEX-i në Kosovë do të:

(...)

(h) merr përgjegjësi të tjera, qoftë ndarazi ose në bashkëpunim me autoritetet kompetente të Kosovës, për të siguruar zbatimin dhe promovimin e sundimit të ligjit, të rendit publik dhe sigurisë, në konsultim me agjencitë përkatëse të Këshillit; dhe

***Ligji Nr. 03/L-053 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (e vlefshme deri me 30 maj 2014)***

### **Neni 3 Juridiksioni dhe kompetencat e gjyqtarëve të EULEX-it në procedurë penale**

(...)

3.3. Para fillimit të fazave përkatëse të procedurës dhe pas kërkesës së prokurorit të EULEX-it të caktuar në lëndë apo që punon në ekipin e përzier të identifikuar në nenet 9 dhe 10 të këtij ligji apo pas kërkesës së cilësdo palë në procedurë, apo pas kërkesës me shkrim të kryetarit të gjykatës kompetente apo të seancës së përgjithshme të Gjykatës Supreme të Kosovës kur nuk zbatohen dispozitat lidhur me përjashtimin e një gjyqtari apo një gjyqtari porotë të parapara sipas KPPPK-së (neni 40-44 i KPPPK-së), Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it do të ketë kompetencë, çdoherë kur konsiderohet e nevojshme që të sigurohet administrimi i duhur i drejtësisë, që t'i caktoj gjyqtarët e EULEX-it në fazën përkatëse të një procedure penale në përputhje me modalitetet për përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të përcaktuara nga Asambleja e gjyqtarëve të EULEX-it dhe në pajtim me këtë ligj, për krimet e poshtëshënuara, atëherë kur hetimi a ndjekja penale nuk kryhet nga PSRK-ja:

(...)

h) shkelja e statusit të barabartë të banorëve të Kosovës (neni 158, KPPK)

### **Neni 12 Kompetencat e prokurorëve të EULEX-it në rast të mosgatishmërisë apo paaftësisë së prokurorëve publik të Kosovës**

12.1. Në secilën fazë të çdo procedure penale, nëse një prokuror publik i Kosovës nuk është i gatshëm apo është i paaftë që të ushtrojë detyrat e tij dhe kjo mosgatishmëri apo paaftësi mund të rrezikojë hetimin apo ndjekjen e duhur të një veprë penale, apo kurdoherë që ekziston dyshimi i bazuar se bëhen përpjekje për të ndikuar në hetimin apo ndjekjen e një veprë penale, Kryeprokurori i EULEX-it ka kompetencë që të kërkojë nga Kryeprokurori i zyrës kompetente që atë lëndë t'ia caktojë: a) një prokurori tjetër publik të Kosovës që punon në të njëjtën zyrë prokuroriale, b) apo cilitdo prokuror të EULEX-it që do të marrë përgjegjësinë për hetimin apo ndjekjen penale përkatëse.

12.2. Nëse Kryeprokurori i zyrës kompetente kundërshton kërkesën e Kryeprokurorit të EULEX-it, Kryeprokurori i EULEX-it do ta njoftoj Kryeprokurorin publik të Kosovës dhe së bashku do të marrin një vendim të përbashkët, i cili do të respektohet nga Kryeprokurori i zyrës kompetente.

12.3. Në rrethana urgjente ose kur vonesa mund të ndikoj në kryerjen apo rezultatin e hetimit, ndjekjen penale apo zhvillimin e drejtë të procedurës, Kryeprokurori i EULEX-it do të ketë të drejtë që të ndërmarrë çfarëdo veprimi urgjent procedural apo të caktoj cilindo prokuror të EULEX-it apo prokuror publik të Kosovës për një qëllim të tillë.

***Ligji nr. 04/L-273 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës***

**Neni 3 Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (e zbatueshme prej 31 majit 2014)**

.....

3. Pas nenit 1 të ligjit bazik, shtohet neni i ri 1.A me tekstin në vijim:

**Neni 1.A Rastet në proces**

Për qëllime të këtij ligji, rast në proces e sipër nënkupton:

1. Rastet për të cilat vendimi për fillimin e hetimeve është dhënë para datës 15 prill 2014 nga prokurorët e EULEX-it në pajtim me ligjin.
2. Rastet të cilat u janë caktuar gjyqtarëve të EULEX-it para datës 15 prill 2014.

.....

9. Neni 7 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

**Neni 7 Autoriteti dhe kompetencat e përgjithshme të prokurorëve të EULEX-it**

7.1. Prokurorët e EULEX-it do të kenë autoritet dhe përgjegjësi t'i kryejnë funksionet në zyrën e tyre, përfshirë autoritetin për kryerjen e hetimeve penale ashtu siç përcaktohet në nenin 2.1 të këtij ligji, përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj.

7.2. Prokurorët e EULEX-it do të jenë kompetentë për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve që janë në kompetencë të PSRK-së në pajtim me ligjin mbi PSRK-në.

7.3. Prokurorët e EULEX-it janë të integruar në sistemin prokurorial të Kosovës dhe do të ushtrajnë funksionet e tyre në pajtim me legjisllacionin në fuqi në Kosovë.

7.4. Rastet e udhëhequra nga prokurorët e EULEX-it të përcaktuara në nenin 2.1 të këtij ligji do të vazhdojnë të menaxhohen në pajtim me dispozitat

përkatëse të Ligjit nr. 03/L-053 mbi Juridiksionin, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (2008) dhe të Ligjit për PSRK-në (2008).

7.5. EULEX KOSOVË do të caktoj prokurorë që të ndihmojnë lidhur me zbatimin, sipas marrëveshjes, të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë të ndërmjetësuar nga BE-ja.

7.6. Gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, prokurorët e EULEX-it do të konsultohen dhe bashkërendojnë aktivitetet e tyre me Kryeprokurorin përgjegjës për zyrën të cilën ata janë të vendosur.

....

10. Pas nenit 7 të ligjit bazik, shtohen dy nene të reja 7.A dhe 7.B me tekstin si në vijim:

Neni 7.A            Autoriteti i prokurorëve të EULEX-it në rrethana të jashtëzakonshme.

Në rrethana të jashtëzakonshme një rast do t'i caktohet një prokurori të EULEX-it me vendim të përbashkët të Kryeprokurorit të shtetit dhe autoritetit kompetent të EULEX-it KOSOVË.

### ***Ligji Nr. 03/L-052 për zyrën e prokurorisë speciale të Republikës së Kosovës***

#### **Neni 5                    Kompetenca e veçantë e PSRK-së**

5.1 PSRK-ja do të ketë kompetencë të veçantë që të hetoj dhe ndjek penalisht krimet, edhe të atyre në formë të tentimit dhe format e ndryshme të bashkëpunimit në krim si vijon:

.....

e) krimet kundër njerëzimit (neni 117, KPPK);

f) krimet e luftës në kundërshtim të rëndë me konventat e Gjenevës (neni 118, KPPK), krimet e luftës si shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktin e armatosur ndërkombëtar (neni 119, KPPK), krimet e luftës për shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët me konventat e Gjenevës (neni 120, KPPK), krimet e luftës të cilat paraqesin shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktet e armatosura që nuk janë në karakterit ndërkombëtar (neni 121, KPPK);

....

n) krimi i organizuar (neni 274, KPPK), kërcënimi gjatë procedurave penale për krim të organizuar (neni 310, KPPK);

.....

#### **Neni 9                    Kompetenca plotësuese e PSRK-së**

9.1 PSRK-ja do të ketë kompetencë plotësuese, sipas modaliteteve të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji, për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet, edhe të atyre në formë të tentimit dhe format e ndryshme të bashkëpunimit në krim si në vijon:

.....

b) nxitja e urrejtjes, e përçarjes ose e mos durimit kombëtar, racor, fetar a etnik (neni 115, KPPK);

.....

- h) vrasja (neni 146, KPPK), vrasja e rëndë (neni 147, KPPK);
- i) marrja e pengjeve (neni 143, KPPK);
- j) shkelja e statusit të barabartë të banorëve të Kosovës (neni 158, KPPK);
- k) rrëmbimi i personit (neni 159, KPPK);

.....

### **Kodi Penal i Republikës së Kosovës**

#### **Neni 106 Parashkrimi i ndjekjes penale**

1. Përveç nëse shprehimisht parashihet ndryshe me këtë Kod, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar afatet e mëposhtme:
  - 1.1. tridhjetë (30) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me burgim të përjetshëm;
  - 1.2. njëzetë (20) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se dhjetë (10) vjet burgim;
  - 1.3. dhjetë (10) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se pesë (5) vjet burgim;
  - 1.4. pesë (5) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se tre (3) vjet burgim;
  - 1.5. tre (3) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një (1) vit burgim; dhe
  - 1.6. dy (2) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme deri në një (1) vit burgim ose me dënim me gjobë.

....

#### **Neni 111 Moszbatueshmëria e parashkrimit për veprat penale kundër të drejtës ndërkombëtare dhe vrasjes së rëndë**

1. Asnjë afat i parashkrimit nuk zbatohet për veprat penale të gjenocidit, krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit ose për vepra të tjera penale, të cilat sipas të drejtës ndërkombëtare nuk parashkruhen.
2. Vepra penale e vrasjes së rëndë nuk parashkruhet.

### **III. ANKESAT**

17. Ankuesja pohon se EULEX-i ka shkelur të drejtat e saj sipas neneve 2 dhe 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Konventa) të pjesëve procedurale të tyre.
18. Në veçanti, ankuesja deklaroi se PSRK-ja e EULEX-it dhe ekipi mobil i prokurorisë së EULEX-it kanë dështuar të fillojnë ndonjë hetim në përputhje me ligjin e Kosovës dhe mandatin e EULEX-it, kanë vonuar padrejtësisht procesin hetimor dhe e kanë referuar çështjen tek prokurorët vendorë duke neglizhuar seriozitetin e lëndës, vendndodhjen gjeografike të krimit (Mitrovica veriore) dhe elementet ndëretnike të krimit. Prandaj, është sugjeruar se prokuroria e EULEX-it kishte obligim që të hetoj plotësisht dhe në mënyrë efektive lëndën nga momenti që është regjistruar në departamentin për mjekësi ligjore të EULEX-it dhe se fajsisht ka dështuar ta bëjë këtë. Kjo mund të ngritë çështjet sipas neneve 8 dhe 13 të Konventës.

## LIGJI

### Parashtrerasat nga palët

19. Në parashtrimet e tij, shefi i Misionit (ShM) ka deklaruar se prokurorët e EULEX-it janë njoftuar rreth kësaj lënde vetëm në vitin 2013, kur ankuesja bëri pyetjet. Ai shpjegoi se nga 9 dhjetori 2008, EULEX-it ka marrë nga prokurorët e UNMIK-ut vetëm dosjet hetimore "aktive", të trajtuara paraprakisht nga prokurorët e tyre, pra dosjet lidhur me hetimet në vazhdim e sipër në datën e dorëzimit. Rastet që ishin ndërprerë, hedhur poshtë ose ndryshe të mbyllura janë arkivuar në zyrat e prokurorisë vendore të Kosovës.
20. ShM më tej ka pohuar se EULEX-i nuk ka marrë ndonjë hap hetimor rreth lëndës, pasi nuk ka pasur ndonjë hetim të hapur nga policia apo prokuroria e EULEX-it dhe nuk ka pasur asnjë dosje të hapur hetimore të bartur nga UNMIK-u në EULEX.
21. ShM më tej ka komentuar rreth kompetencës së EULEX-it për t'u marrë me lëndën. Ai parashtron se para amendamenteve legjislative të prillit të vitit 2014 mbi Ligjin nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Kosovë (Ligji mbi kompetencat) të EULEX-it, prokurorët e EULEX do ta kishin ndarë apo do të kishin kompetencë dytësore mbi lëndën, nëse do të klasifikoheshin si rrëmbim, pengmarrje apo vrasje. Sipas tij, për shkak të faktit se incidenti ka ndodhur pas përfundimit të konfliktit, lënda nuk mund të konsiderohet si krim lufte, ku në këtë rast EULEX-i do të kishte kompetenca ekskluzive. ShM shton se amendamentet në Ligjin mbi Kompetencat kanë ulur mundësinë që prokurorët e EULEX-it të ushtrojnë funksionet ekzekutive në lëndë të reja. Pasi asnjë hetim nuk kishte nisur rreth lëndës para se amendamentet të hynin në fuqi, lënda nuk konsiderohet se është në proces e sipër dhe për këtë arsye në parim bie jashtë juridiksionit të EULEX-it.
22. Megjithatë, ShM vuri në dukje se lënda ka mbetur nën kompetencën e ekspertëve të departamentit të mjekësisë ligjore të EULEX-it, të ngarkuar me lëndët e personave të zhdukur.
23. Përveç kësaj, ShM ka ofruar disa vërejtje në lidhje me pranueshmërinë e ankesës. Ai ka pohuar se detyra kryesore e EULEX-it është të mbështes autoritetet vendore, duke i mbajtur disa funksione të kufizuara ekzekutive. Prandaj, përgjegjësia e tij për të mbrojtur të drejtat e njeriut nuk mund të barazohet me atë të një shteti.
24. ShM gjithashtu ka pohuar se Paneli është kompetent të shqyrtoj vetëm shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it, kështu që ankesat në lidhje me veprimet apo mosveprimet e autoriteteve të KFOR-it, UNMIK-ut apo të autoriteteve të Kosovës bien jashtë kompetencave të tij. Sipas ShM, kjo lëndë nuk ka qenë

nën hetim nga prokurorët e EULEX-it apo nga policia e EULEX-it, prandaj duhet që mos të pranohet në përputhje me rregullën 25, par. 1 të rregullores së punës së Panelit.

25. Sa i përket kompetencës lëndore të Panelit, kjo lëndë nuk ka hyrë në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it para se të ndryshohej në qershor të vitit 2014, pasi ajo kishte të bënte me një rast të persi të zhdukur. Megjithatë, ajo kurrë nuk arriti zyrtarisht tek policia e EULEX apo prokurorët e EULEX-it dhe nuk janë kryer veprime ekzekutive nga ta që t'i mund të kishin prekur të drejtat e ankueses. Aktualisht, thuhet se lënda është në kompetencën ekskluzive të autoriteteve të Kosovës.
26. Për më tepër, ShM pohoj se Paneli shqyrton vetëm ankesat rreth shkeljeve të pohuara të të drejtave të njeriut që kanë ndodhur pas datës 9 dhjetor 2009. Babai i ankueses është zhdukur në vitin 2000. ShM ka citur në gjetjet e Panelit në lëndën *Thaqi kundër EULEX-it* (nr. 2010-02) se *“duhet të ketë një lidhje të vërtetë ndërmjet vdekjes dhe datës që shënon fillimin e juridiksionit të Panelit në mënyrë që të hyjnë në fuqi obligimet procedurale të vendosura me nenin 2. Në praktikë, kjo do të thotë se një pjesë e konsiderueshme e hapave procedurale të kërkuara nga kjo dispozitë kanë qenë, ose duhet të ishin kryer pas datës kritike”*. ShM vuri në dukje faktin se rasti ishte joaktiv për disa vite dhe se asnjë informacion i ri nuk ka dalë në dritë pas dorëzimit të lëndëve nga UNMIK-u në EULEX. Pjesa e konsiderueshme e nevojshme e hapave procedurale ishte ose duhet të ishte kryer nga UNMIK-u, para kësaj date. Sipas ShM mungonte *“lidhja e vërtetë”* mes zhdukjes dhe 9 dhjetorit 2009 si datë e fillimit të juridiksionit, kështu që Paneli nuk ishte kompetent për të shqyrtuar këtë çështje.
27. ShM gjithashtu pohoj se lënda është parashtruar jashtë afatit kohor prej gjashtë muajsh të përcaktuar me rregulloren e punës së Panelit. ShM është mbështetur në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në veçanti *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë [GC]*, ku Gjykata konsideroi se *“aty ku ka ndodhur ndonjë vdekje, të afërmit e aplikantit priten të ndërmarrin hapa për të përcjellë progresin e hetimit ose mungesën e tij dhe të parashtrojnë kërkesat e tyre pa vonesë pasi të jenë ose duhet të ishin të njoftuar për mungesën e ndonjë hetimi efektiv penal (...). Të njëjtat parime janë zbatuar, mutatis mutandis, në rastet që lidhen me zhdukjet (...)*”. ShM ka pohuar se EULEX-i u bë funksional kah fundi i vitit 2008, ndërsa Paneli është themeluar në tetor 2009. Sipas ShM, ankuesja mund të kishte kontaktuar me EULEX-in më herët se dhjetori i vitit 2013. ShM ka konkluduar se pasi që ankuesja nuk arriti ta zë Panelin brenda afatit përkatës prej 6 muajsh, lënda duhet të shpallet e papranueshme.
28. Në përgjigje ndaj parashtrimeve të ShM-së, ankuesja ka hedhur poshtë argumentin e tij se zhdukja e babait të saj nuk mund të konsiderohet krim lufte. Ajo citoi nenin 1 të Ligjit nr. 04/L-023 për

personat e zhdukur në Kosovë, i cili thotë se një person që *“raportohet i zhdukur gjatë periudhës [midis] 1 janarit 1998 [dhe] 31 dhjetor 2000” konsiderohet person i zhdukur “si pasojë e luftës në Kosovë gjatë viteve 1998-1999”*. Pasi babai i ankueses është zhdukur para 31 dhjetorit 2000, ajo ka pohuar se ka pasur një supozim ligjor që zhdukja e tij ishte mjaftueshëm e lidhur me konfliktin në Kosovë në mënyrë që të përbënte krim lufte. Për më tepër, ajo vuri në dukje një letër të 20 dhjetorit 2013, në të cilën EULEX-i deklaroi: *“Ne e kuptojmë dhimbjen që ndiejnë familja dhe miqtë e viktimave dhe personave të zhdukur nga lufta ... [dhe] gjykimi i krimeve të luftës mbetet një nga prioritetet kryesore të EULEX-it”*. Ankuesja e konsideron këtë si një tregues rreth të kuptuarit të Misionit se ky akt mund të përbëj krim lufte. Ankuesja argumentoi gjithashtu se krimi kundër babait të saj ishte pjesë e një fushate sistematike të zhdukjeve në Kosovë dhe si i tillë përbën një krim kundër njerëzimit, që hyn në kuadër të kompetencave të EULEX-it. Gjithashtu kishte një karakter të një krimi ndëretnik, i cili EULEX-i është i obliguar ta hetoj dhe ndjek penalisht në bazë të nenit 3 të Veprimit të Përbashkët të Këshillit dhe nenit 11 të Ligjit mbi Kompetencat.

29. Ankuesja pohoj se asnjë ndarje e mundshme e detyrave midis zyrave të ndryshme të EULEX-it dhe mungesa e komunikimit midis tyre nuk mund ta arsyetoj ikjen e EULEX-it prej obligimeve të veta për të hetuar në mënyrë efektive lëndën që nga momenti kur u njoftua për këtë. Për më tepër, një hetim efektiv nga EULEX-i mbetet thelbësor në korrigjimin e shkeljes së të drejtave të ankueses.
30. Ankuesja konkludoj se nëse EULEX-i nuk i përdor të gjitha mjetet e mundshme në dispozicion të tij për ta zbatuar obligimin e tij për hetim, të drejtat e ankueses sipas neneve 2 dhe 3 të KEDNJ-së, si dhe procedura pranë Panelit për mbrojtjen e atyre të drejtat, do të mbeten teorike dhe iluzion. Prandaj ankuesja ka kërkuar nga Paneli ta urdhëroj EULEX-in që të shfrytëzoj nenin 7 (a) të Ligjit mbi Kompetencat, i cili flet për mundësinë që një lëndë t'i caktohet EULEX-it dhe t'i caktohen mjete të tjera në dispozicion për të hetuar lëndën në mënyrë efektive. Ankuesja gjithashtu kërkon kompensim për dëmin që i është shkaktuar.

### **Vlerësimi i Panelit**

*Mandati i Panelit (Rregulla 25 par. 1 i Rregullores së Punës) dhe kufizimet e pandara të vëna mbi Misionin lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut*

31. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar të zbatoj instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Liritë Themelore të Njeriut dhe Konventa

Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet demokratike ligjore.

32. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do t'i pranoj ankesat, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregullën 29 të Rregullores së vet të punës.
33. Sipas rregullës 25, paragrafi 1, Paneli mund të shqyrtoj vetëm ankesat lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv.
34. Paneli tashmë ka vendosur se veprimet e prokurorëve dhe të policisë së EULEX-it janë pjesë e mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë dhe për këtë arsye bien në kuadër të mandatit të Panelit (shih për shembull *K deri te T kundër EULEX-it*, lëndët nr. 2013-05 në 2013-14, 21 prill 2015 § 43; *Krlc kundër EULEX-it*, nr. 2012-21, 26 gusht 2014, § 23; *Y kundër EULEX-it*, nr. 2011-28, 15 nëntor 2012, § 35).
35. Paneli gjithashtu ka pasur rastin të theksohej se Misioni i EULEX-it nuk është shtet dhe se aftësia e tij për të garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut nuk mund të krahasohet në të gjitha aspektet përkatëse me atë që mund të pritët prej një shteti (shih vendimin e Panelit në *A, B, C, D kundër EULEX-it* nr. 2012-09 deri te 2012-12, 20 qershor 2013, § 50; *K deri te T kundër EULEX-it*, të cituar më lartë, § 53; krahasoni edhe vendimin e PKDNj-së në lëndët nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, 25 prill 2013, §35).
36. Paneli gjithashtu vëren vështirësitë që domosdoshmërisht përfshihen në hetimin e krimeve të rënda në një shoqëri të pasluftës, siç është Kosova (shih *Palic kundër Bosnjës dhe Hercegovinës*, nr. 4704/04, 15 shkurt 2011 § 70; Vendimi i PKDNj-së në lëndët nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, cituar më lartë, par. 44 dhe 62 e tutje). Megjithatë, këto vështirësi nuk duhet të shërbejnë për t'i kamufluar apo shpjeguar dështimet që në asnjë mënyrë të rëndësishme nuk lidhen me të metat e një hetimi. Prandaj në secilin rast Paneli do të vlerësoj nëse ndonjë hap i veçantë hetimor që normalisht ishte i hapur do të kishte qenë i pamundur apo jopraktik për arsyet që lidhen me rrethanat e pas konfliktit.
37. Prandaj pritjet e vëna mbi aftësinë e EULEX-it për të hetuar dhe për të zgjidhur lëndë të ndërlikuara penale duhet të jenë realiste. Pra Paneli nuk do të vendos mbi misionin një barrë disproporcionale që mandati dhe burimet e saj nuk janë të gjendje të përmbushin (shih vendimin e PKDNj-së në lëndët nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, cituar më lartë, §§ 70-71). Në çdo rast, pritët nga Paneli që të shqyrtoj nëse ka pasur pengesa konkrete dhe reale që mund të kenë dëmtuar mundësinë që EULEX-i ta kryente ndonjë hetim të shpejtë dhe efektiv të një lënde. Një vlerësim i tillë nuk ka për qëllim që të arsyetoj të metat

operacionale që nuk kanë të bëjnë me sfidat konkrete dhe të demonstrueshme, por për të siguruar se Misioni nuk pritet të bëjë më shumë sesa në mënyrë të arsyeshme do ta lejonin mandati dhe burimet e tij.

38. Në çdo rast, në veçanti në rastet e këtij serioziteti, autoritetet hetimore priten të veprojnë shpejt për aq sa është e arsyeshme dhe të përdorin burime në përputhje me nevojën dhe mundësinë për zgjidhjen e lëndës. Përderisa autoritetet hetuese nuk mund të priten t'i zgjidhin të gjitha lëndët e sjella para tyre, prej tyre pritet që në çdo rast të veprojnë me zell, shpejtësi dhe efikasitet të tillë që e pasqyrojnë seriozitetin e lëndës, e cila është duke u hetuar (*shih Varnava dhe të Tjerët kundër Turqisë* [GC], § 191, KEDNj 2009; *Palic kundër Bosnjë dhe Hercegovinës*, cituar më lartë, § 63). Një angazhim dhe përkushtim i rreptë me këto standarde është veçanërisht i rëndësishëm për një mision të sundimit të ligjit si EULEX që ka për qëllim të shërbejë si shembull i përkushtimit të shoqërisë për t'i dhënë fund mosndëshkimit dhe për ndërtimin e një ndjenje të fortë të përgjegjësisë ndaj shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut. Çfarëdo standardi më pak se ky do të rrezikonte krijimin e një ndjenje pajtimi me mosndëshkimin dhe mospërfilljen e kërkesës legjitime të viktimave për drejtësi dhe llogaridhënie (shih vendimin e PKDNj-së në lëndët nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, cituar më lartë, § 80).
39. Në kontekstin e tanishëm ka pak argumente se hetimi i fatit të të zhdukurve - pa dallim feje apo etnie - duhet të mbetet prioritet operacional për EULEX-in si mision për sundimin e ligjit, për të cilën duhet t'i ofrohen burime të mjaftueshme.

#### *Pajtueshmëria me rregullën e afatit 6 mujor*

40. Në bazë të rregullës 25, paragrafi 3, i Rregullores së Punës së Panelit, parashtuesi i ankesës është i detyruar të paraqes ankesën brenda gjashtë muajve nga vepra, vendimi apo sjellje, e cila thuhet se përbën ose përfshin ndonjë shkelje të të drejtave të tij/saj (shih, p.sh. *Gashi kundër EULEX-it*, nr. 2013-22, 7 prill 2014, § 10; *Thaqi kundër EULEX-it*, cituar më lartë, § 51).
41. Siç u përmend më lartë, ShM ka pohuar se ankuesja nuk ka arritur të përmbush këtë kërkesë procedurale.
42. Parashtrimet e ShM-së në këtë pikë duken se janë të bazuara në një keqkuptim rreth asaj se me çfarë ka të bëjë ankesa. Përderisa i afërmi i ankueses është zhdukur më 7 dhjetor 2000, shkelja e supozuar e të drejtave të rëndësishme lidhur me këtë ankesë nuk ka të bëjë me atë ngjarje, por ka të bëjë me dështimin e supozuar të mëvonshëm dhe të vazhdueshëm nga ana e autoriteteve për të hetuar në mënyrë të duhur rrethanat e asaj zhdukje.

43. ShM gjithashtu i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e cila ai thotë se mbështet pozicionin e tij. Në veçanti, ShM i referohet lëndës *Varnava dhe të Tjerët kundër Turqisë* [GC], ku gjykata ka specifikuar se “*aty ku ka ndodhur vdekja, të afërmit e aplikantit priten të ndërmarrin hapa për të përcjellë progresin e hetimit ose mungesën e tij dhe për të parashtruar aplikacioniet e tyre pa vonesë, menjëherë pasi ata janë ose duhet të ishin të njoftuar për mungesën e ndonjë hetimi efektiv penal (...). Të njëjtat parime janë zbatuar mutatis mutandis (me ndryshimet e nevojshme) edhe në rastet me personat e zhdukur (...)*”.
44. Paneli thekson se nga ankuesit në parim pritet që të kërkojnë mjetet ligjore në dispozicion të tyre me energji dhe të paraqesin ankesën e tyre pa vonesë (shih, p.sh. *Bulut dhe Yavuz kundër Turqisë* (vendim), nr. 73065/01, 28 maj 2002 dhe, *a contrario, Eren dhe të Tjerët kundër Turqisë* (vendim), nr. 42428/98, 4 korrik 2002, dhe *Ûçak dhe Kargili dhe të Tjerët kundër Turqisë* (vendim), nr. 75527/01 dhe 11837/02, 28 mars 2006).
45. Në rastin konkret, ankuesja nuk duket se kanë ndërmarrë hapa serioz midis vitit 2001 dhe 2013 për t'i realizuar të gjitha mjetet juridike në dispozicion të saj. Asnjë shpjegim nuk është dhënë për të arsyetuar këtë pasivitet.
46. Megjithatë, tre faktorë kanë çuar Panelin që të konsiderojnë këtë çështje më tutje: së pari, të drejtat e përfshira në këtë rast janë ndër të drejtat më të rëndësishme themelore të garantuara nga ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Disa prej tyre janë absolute dhe nuk kanë ndonjë përjashtim (neni 15 (2) të Konventës; shih gjithashtu *McCann dhe të Tjerët kundër aktgjykimit të Mbretërisë së Bashkuar* të datës 27 shtator 1995, Seria A nr. 324, §147; aktgjykimi *Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar* i datës 18 janar 1978, Seria A nr. 25, § 163; *Vo kundër Francës* [GC], nr. 53924/00, § 88, KEDNJ 2004-VIII). Së dyti, kompetenca e prokurorëve të EULEX-it për të hetuar shkeljet e pohuara të këtyre të drejtave është e pavarur prej ndonjë ankese të paraqitur nga viktimat apo prej të afërmeve të tyre, pra ka pasur një pritje ligjrisht të bazuar se ata do ta shqyrtonin këtë rast, pavarësisht nga veprimet e ankueses. Së treti, hetimi i plotë dhe i efektshëm i kësaj kategorie të rasteve është thelbësor për ndërtimin e një ndjenje të përgjegjësisë dhe kujdesit për sundimin e ligjit në çdo shoqëri pas konfliktit. Përgjegjësia për t'u marrë me këto raste i takon shoqërisë si një tërësi dhe jo vetëm atyre që janë prekur drejtpërdrejtë me të. Mbi këtë bazë, Paneli konsideron se është në interes të drejtësisë se duhet ta merr parasysh ankesën lidhur me pranueshmërinë e saj.
47. Përveç kësaj, Paneli konsideron se ankuesja mund të ketë pasur një bazë të mirë për të besuar (megjithëse gabimisht) se lënda ishte ende duke u hetuar gjatë kësaj periudhe kohore. Ndërmjet dhjetorit 2000 dhe shkurtit të vitit 2001, deklaratat janë marrë nga dëshmitarët. Duke filluar në dhjetor të vitit 2013 dhe gjatë gjithë kohës deri me 13 qershor 2014, ankuesja është përpjekur që të merr informacion nga

EULEX-i në lidhje me këtë rast dhe për statusin e hetimit. Gjatë kësaj periudhe, ankuesja në mënyrë legjitime mund të supozonte se diçka ishte duke u bërë në lidhje me këtë rast. Përgjigja e 20 dhjetorit 2013 nga Zyra e Shefit të Stafit do t'i kishte dhënë asaj shpresë se lënda ishte ende e hapur dhe ishte nën hetime. Vetëm përmes letrës së datës 13 qershor 2014 nga ekipi mobil i prokurorëve të EULEX-it, ankuesja do të informohej rreth qëndrimit të Misionit se Misioni nuk e konsideronte veten kompetent rreth kësaj lënde. Sipas pikëpamjes së Panelit, kjo mund që me të drejtë të konsiderohet si pika prej së cilës fillon afati 6 mujor.

48. Për arsyet e cekura më lartë, ankesa është parashtruar me kohë.

*Lidhja e mjaftueshme kohore me sjelljen në fjalë - Kompetenca e Panelit ratione temporis*

49. ShM argumenton se Paneli nuk ka juridiksion *ratione temporis* mbi këtë rast, i mungon një lidhje e mjaftueshme kohore midis sjelljes në fjalë dhe parashtrimin të ankesës në Panel. Paneli nuk pajtohet.
50. ShM tregon për faktin se babai i ankueses është zhdukur kohë më parë dhe para se të krijohet EULEX-i. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se Paneli nuk do të ishte kompetent për të hetuar këtë rast. Sjellja që në të vërtetë është duke u shqyrtuar në këtë rast (një dështim i supozuar nga ana e Misionit për të hetuar këtë rast) të paktën ka filluar në dhjetor të vitit 2013 (nëse jo më herët) dhe e cila është thënë se ende është në vazhdim e sipër deri në këtë pikë. Në këtë kuptim, kjo bie në kuadër të kompetencës kohore të Panelit.
51. Ndërlidhja e Misionit me këtë rast më tutje është theksuar në këtë lëndë nga fakti se seksioni i mjekësisë ligjore ka qenë dhe vazhdon të jetë i përfshirë me këtë çështje që nga viti 2008 kur dosja e lëndës është komunikuar nga UNMIK-u në Departamentin e EULEX-it për Mjekësi Ligjore (DML). Në asnjë moment që nga ajo kohë deri me 13 qershor të vitit 2014, ankueses nuk ju është thënë se Misioni nuk ishte dhe nuk do ta hetonte këtë rast. Deri në atë moment, ankuesja ligjërisht mund të konsideronte se Misioni do ta hetonte këtë rast dhe ajo bëri presion që kjo të bëhej.
52. Bazuar në atë që u tha më lartë, Paneli është i bindur se ka një lidhje, të mjaftueshme dhe të mirëfilltë në mes të sjelljes në fjalë, relevante me këtë rast, dhe mandatit të Misionit (dhe kompetencës së Panelit) kështu që Paneli e deklaroi veten se është kompetent *ratione temporis* për t'i shqyrtuar meritat e kësaj lënde.

*Kompetenca e EULEX-it mbi krimin e supozuar dhe ratione materiae e Panelit*

53. ShM gjithashtu kundërshton pranueshmërinë e këtij rasti në bazë të mendimit se ky rast nuk ka hyrë në kompetencë të prokurorëve të EULEX-it, kështu që asnjë veprim apo dështim nuk mund t'i ngarkohet Misionit që ka kontribuar në shkeljen e të drejtave të ankueses. Paneli nuk pajtohet me këtë analizë.
54. Si çështje paraprake, Paneli thekson në kundërshtim me parashtrirat e ShM-së (Përgjigja, fq. 11) se kjo ankesë ka të bëjë jo me veprimet/mosveprimin e KFOR-it/UNMIK-ut, por për ato që është thënë se i atribuohen Misionit. Kompetenca e Panelit është gjithashtu e kufizuar në ato veprime të pretenduara dhe në lëshimet që i atribuohen Misionit gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv.
55. Lidhur me kompetencën e tij *ratione materiae*, Paneli parashtrirte e ShM-së i vëren si një çështje paraprake, të cilat në mënyrë të qartë parashohin faktin se prokurorët e EULEX-it kanë një kompetencë të përgjithshme mbi këtë lloj të lëndëve:
- ShM është njoftuar për rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të garantuara me nenet 2 dhe 3 të Konventës, siç thuhet se janë shkelur në këtë rast ("EULEX-i është angazhuar për të siguruar që të gjitha aktivitetet e saj respektojnë standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut" (përgjigje, fq. 10) dhe e njuh" karakterin themelor dhe rëndësinë e të drejtave të mbrojtura sipas neneve 2 dhe 3 të KEDNj-së, si dhe obligimet procedurale të lidhura me ato të drejta" (aty)).
  - Kompetenca e përgjithshme e EULEX-it mbi rastet e zhdukjeve në fakt është pranuar nga ShM (Përgjigje, fq. 4: "Personat e zhdukur si të tillë nuk janë përmendur në këtë dispozitë [Neni 3(d) i Veprimit të Përbashkët të vitit 2008], por natyrisht ekspertët e EULEX-it duke punuar në DML kanë qenë të përfshirë në gjetjen dhe zbardhjen e fatit të personave të pagjetur.").
  - Shefi i Misionit po ashtu ka theksuar faktin se Misioni ka qenë i angazhuar në këtë çështje përmes DML ("Në praktikë, ekspertët e EULEX-it në kuadër të DML-së kanë qenë përgjegjës për punën e Identifikimit, Bashkërendimit dhe Përkrahjes për rastet e 'personave të pagjetur'." (Përgjigje, fq. 6); dhe Përgjigje, fq. 7 (duke vënë në dukje se rasti "ka qenë nën kompetencën e ekspertëve të DML-së së EULEX-it të ngarkuar me rastet e personave të pagjetur dhe vazhdon të jetë nën kompetencën e tyre edhe pas ndryshimit të mandatit").
  - ShM ka bërë gjithashtu të qartë se po të kishte informacion të ri, Misioni do të mund ta kishte 'aktivizuar' këtë rast, kështu në mënyrë implicite ka pranuar kompetencën e përgjithshme të Misionit rreth rasti (përgjigja e ShM, fq. 11: "Në praktikë rasti ka qenë joaktiv për vite për shkak të mungesës së ndonjë të dyshuari të arsyeshëm ose për shkak të mungesës për të çuar drejt gjetjes së babait të ankueses para se rasti të ishte parashtruar në EULEX. Rasti mund të bëhet përsëri aktiv brenda DML-së në një situatë ku do të gjendeshin disa mbetje

mortore që do të përputheshin me të dhënat dhe mostrat e ADN-së që kanë hyrë në bazën e të dhënave të këtij rasti të veçantë. Megjithatë, siç është argumentuar më lartë, çështja penale ka hyrë në kuadër të kompetencës primare të policisë dhe prokurorisë së Kosovës dhe aktualisht është në kompetencën ekskluzive të autoriteteve të Kosovës.”).

56. Këto parashtresa dhe përfundimi i nevojshëm se në parim prokurorët e EULEX-it kanë qenë kompetent dhe të autorizuar për të hetuar këtë rast më tej mbështeten nga dispozitat përkatëse ligjore. Së pari, duke lënë mënjanë çështjen nëse ky veprim mund të cilësohet si krim lufte, sjellja në fjalë ka indikacione *prima facie* se ajo ishte etnikisht e motivuar, kështu do të kishte hyrë në kuadër të “krimeve të tjera të rënda” sipas nenit 3(d) të Veprimit të Përbashkët të vitit 2008 mbi të cilën prokurorët e EULEX-it kanë kompetenca.
57. Neni 8 i Ligjit mbi Kompetencat ka të bëjnë me rrëmbim, pengmarrje dhe vrasje dhe neni 11-12 i Ligjit mbi Kompetencat që ka të bëjnë me krimet e motivuara nga urrejtja gjithashtu do të kishin ofruar një bazë të vlefshme ligjore për prokurorët e EULEX-it për të hetuar këtë rast. Kjo në fakt është pranuar nga ShM-ja (Përgjigja fq. 7: “Prokurori i EULEX-it do të kishte pasur ose një kompetencë të përbashkët apo mund të kishte pasur një kompetencë plotësuese mbi rastin në fjalë, nëse ajo do të ishte klasifikuar se rrëmbim, pengmarrje ose vrasje.”).
58. Megjithatë ShM argumenton se këto dispozita nuk “vendosin obligim themelor mbi prokurorët e EULEX-it për të vepruar”. Megjithatë këtu çështja nuk është e lidhur me një “obligim”, por ajo lidhet me juridiksionin ose kompetencën e prokurorëve të EULEX-it për të hetuar këtë çështje. Dhe dispozitat e cituara më sipër në mënyrë të qartë kanë dhënë një bazë të mjaftueshme ligjore që i jep autoritet prokurorit të EULEX për të hetuar këtë rast. Obligimi i Misionit për të vepruar kështu lind për këto qëllime jo nga këto dispozita, por nga nenet 2-3 të Konventës Evropiane, të cilat i japin mandat atyre që obligohen nga Konventa për të hetuar shkeljet e dyshuara të këtyre të drejtave (*McCann dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lartë, §161, *Assenov dhe të Tjerët kundër Bullgarisë*, aktgjykimi i datës 28 tetor 1998, Raportet e Aktgjykimeve dhe Vendimeve 1998-VIII, § 102). Në këtë kuptim, kompetenca juridiksionale (“mundësi”) që këto dispozita parashohin janë të mjaftueshme për vendosjen e kompetencave të Panelit mbi këtë rast.
59. ShM ngrit një tjetër “përrjashtim” prej kompetencave të prokurorëve të EULEX-it, pra zbatimin e statusit të parashkrimit lidhur me aktet që do të përbënin rrëmbim apo pengmarrje. Statusi i parashkrimit të veprave të tilla duket se është 10 deri në 20 vjet, varësisht nga rrethanat e rastit (nenet 106, 175 dhe 194 të Kodit Penal të Kosovës). Paneli së pari vëren se ShM nuk ngrit ndonjë përrjashtim të tillë në lidhje me sjelljen që do të përbënte vrasje dhe/apo krim etnikisht të motivuar kështu që ky aspekt i çështjes nuk do të prekej. Së dyti, edhe nëse sjellja në fjalë do të ishte konsideruar se tërësisht ose pjesërisht

përbënte rrëmbim apo pengmarrje, përgjegjësia e EULEX-it për ta bërë hetimin do të ishte shuar vetëm diku në vitin 2010. Dështimi i tij për të hetuar rastin deri në atë pikë prapë ngrit çështjen sipas neneve 3, 8 dhe shumë e mundshme edhe nenit 13 të Konventës. Për më tepër, Paneli konsideron se është tejet e pamundur që një person i rrëmbyer ose i marrë peng dhe i pagjetur për 16 vjet, ende të jetë gjallë. Vrasja e rëndë (e rëndë për shkak të motivit të mundshëm etnik) nuk parashkruhet (shih nenin 111 të KPP-së). Rezulton se vrasja dhe aspektet ndëretnike të këtij rasti do të mbeteshin të pa-prekura me kalimin e kohës. Në këto rrethana, Paneli nuk pranon se parashkrimi do të përbënte ndonjë pengesë ndaj kompetencës së tij që ta shqyrtoj këtë çështje në bazë të meritave të saj.

60. Dy argumente të tjera duhet të merren parasysh. E para është se prokurorët e EULEX-it asnjëherë nuk u bënë zyrtarisht kompetent për të hetuar këtë çështje, pasi kjo dosje e lëndës zyrtarisht nuk ju është dhënë atyre. Paneli nuk mund t'i pranoj këto parashtrime, të paktën për dy arsye. E para është se kjo është përgjegjësi e Misionit për të siguruar se e organizon veten në një mënyrë të tillë që të garantoj mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv.
61. Së dyti, pohimi se çështja nuk ka arritur në Mision bie në kundërtënie me faktin se të dhënat e këtij rasti kanë qenë nën kontrollin e DML-së të paktën që prej dhjetorit 2008. Pasi që rasti ishte në një bazë të të dhënave në të cilën prokurorët e EULEX-it kishte qasje, ky informacion mund të thuhet se në mënyrë konstruktive ka qenë në kontrollin e tyre. Gjatë ushtrimit të zellshëm të përgjegjësive të tyre, ata duhej dhe kanë mundur të kenë marrë informacionin në lidhje me këtë rast. Tashmë Paneli ka theksuar në rastet e mëhershme se nga një Mision siç është EULEX-i pritet që t'i organizoj të dhënat e veta dhe t'i bart ato në atë mënyrë që do të ishte në gjendje të garantoj në të gjitha rrethanat mbrojtjen efektive të të drejtave të të prekurve në ato dosje (*Becic kundër EULEX-it*, 2013-03, 12 nëntor 2014, §§ 58-60). Për më tepër, në një lëndë të kësaj rëndësie, nuk është e paarsyeshme të pritet se ekspertët e EULEX-it të ngarkuar me këtë dosje do të duhej ta kishin sjellë atë në vëmendjen e autoriteteve kompetente hetimore me qëllim që të sigurohej se rasti ishte duke u hetuar siç duhej.
62. Së fundi, ShM pohon se legjislacioni i ri që ka hyrë në fuqi me 31 Maj 2014 ka "ulur ndjeshëm mundësinë e prokurorëve të EULEX-it dhe gjyqtarëve për të ushtruar funksione ekzekutive në lëndë të reja" (Përgjigje, fq. 6, duke iu referuar Ligjit omnibus që ka ndryshuar Ligjin për kompetencat). Megjithatë Paneli vëren se neni 7(A) parashikon "Autoritetin e prokurorëve të EULEX-it në rrethana të jashtëzakonshme": "Në rrethana të jashtëzakonshme një lëndë do t'i caktohet një prokurori të EULEX-it me një vendim të përbashkët nga kryeprokurori i shtetit dhe autoriteti kompetent i EULEX-it KOSOVË. "ShM nuk ka arritur të shpjegoj pse kjo dispozitë nuk ofron ndonjë bazë të duhur ligjore mbi të cilën prokurorët e EULEX-it duhet të

veprojnë, në mënyrë të veçantë në një rast të tillë si kjo lëndë, ku autoritetet vendore nuk duket se janë duke bërë hetime. Paneli fton palët që ta adresojnë këtë çështje nëse dëshirojnë të bëjnë parashtrësë shtesë në lidhje me meritat e kësaj lënde.

63. Bazuar në atë që u përmend më sipër, Paneli është i bindur se të gjitha kërkesat përkatëse juridikionale janë plotësuar në mënyrë që lënda të shpallet e pranueshme.

### **PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI**

**SHPLL TË PRANUESHME**, pa paragjykuar meritat e çështjes, ankesën në lidhje me shkeljet e pohuara të neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; dhe

**KËRKON SQARIMET VIJUESE** nga palët dhe i fton të bëjnë parashtrime shtesë në lidhje me to në qoftë se dëshirojnë:

1. A do të kenë kompetencë prokurorët e EULEX-it për të hetuar, siç mund të ndodh, dhe për të ndjekur penalisht këtë çështje në pajtim me "rrethanat e jashtëzakonshme" të nenit 7(A) të Ligjit të ndryshuar mbi Kompetencat dhe nëse po cilat faktorë duhet të jetë relevante në vendimin e tyre për të vepruar në një rast të veçantë?
2. A ka marrë Misioni hapa për të shqyrtuar lëndët e bartura nga UNMIK-u, të cilat ishin "joaktive" dhe nëse po cilat janë ato hapa? A kanë pasur ndonjë mjet prokurorët e EULEX-it për t'ju qasur të dhënave apo dosjeve të lëndëve, të cilat janë cilësuar nga UNMIK-u si "joaktive"?
3. A janë shkelur nga EULEX-i ndonjë prej të drejtave të ankueses sipas nenit 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës?

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA  
Kryesuese